



Titulli i projektit

Përpilimi i hartës elektronike të Kukësit me synim promovimin e turizmit.

Tipi i projektit

Zhvillim i qëndrueshëm mjedisor, social dhe ekonomik

Vendndodhja e projektit

Zona Funksionale Kukës

Buxheti i paravlerësuar

200,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Në ditët e sotme, faqet web ofrojnë mënyra të reja për të vënë informacion në dispozicion të përdoruesit. Kjo krijon mënyra të reja dhe mjete që mund të përdoren për të krijuar informacionin për turistët dhe për të promovuar destinacionet turistike. Objektiv i kryesor i kësaj pune është që të zhvillojë një aplikim Web për zhvillimin e turizmit në rajonin e Kukësit. Ky aplikacion Web përdor harta dinamike dhe karakteristika të përbajtjes të gjeneruara nga përdoruesit, të cilat janë të fokusuara në ofrimin e informacioneve të dobishme për turistët dhe në promovimin e Turizmit të Natyrës dhe të Aventurës në rajonin e Kukësit. Zhvillimet në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK) kanë transformuar turizmin në mënyra të shumta, në fusha të tilla si ajo e kërkesës së konsumatorëve, apo menaxhimit të faqes. Të dhënat e ndryshme për destinacionet mund të luajnë një rol të madh në zgjedhjen e turistëve për pushime, duke përdorur internetin si një mjet të privilegjuar për kryerjen e kësaj detyre. E-Turizmi përfaqëson hulumtimin e kombinuar të TIK në turizëm. Ky fakt po e ndryshon me shpejtësi sektorin e turizmit, duke bërë thirrje për një adaptim të vazhdueshëm dhe për integrimin e zhvillimeve të fundit të TIK në sektorin e turizmit. Këshilli i Qarkut Kukës ka grumbulluar disa të dhëna të caktuara, që mundësojnë informimin për vendimmarrjen për planifikimin strategjik dhe strategji të investimeve. Si rezultat i sukseseve dhe dështimeve të kaluara, është identifikuar nevoja për të përdorur një software të avancuar GIS me mbështetjen e infrastrukturave teknologjike. Gjithashtu është e qartë nevoja për të trajnuar dhe për të përmirësuar kapacitetet vendore për mbledhjen e të dhënave, me qëllimin dhe synimin e përmbytjes së objektivave të këtij veprimi. Përveç kësaj, vlerësohet i domosdoshëm harmonizimi i mbledhjes së të dhënave të tilla dhe i infrastrukturave teknologjike, duke lehtësuar në maksimum shkëmbimin e informacionit. Paralelisht me ndërhyrjen në infrastrukturën teknologjike, vëmendje i duhet kushtuar përmirësimit të kapaciteteve vendore, duke përfshirë komunitetin e biznesit, të OJF-ve dhe njësitë e qeverisjes vendore. Janë këto komunitete që i japin informacion dhe të dhëna Këshillit të Qarkut, Bashkisë dhe institucioneve të tjera. Pasi të mblidhen, këto të dhëna duhet të ruhen, analizohen e pastaj të shpërndahen në publik për t'u përdorur sipas nevojave.

Qëllimi/et specifik të projektit

Promovimi i turizmit, burimeve natyrore dhe pasurive kulturore në Zonën e Kukësit, nëpërmjet përdorimit të sistemit të teknologjisë së informacionit.

1. Objektivat specifike të projektit

OS1: Të krijohet sistemin e mbledhjes, menaxhimit dhe shfrytëzimit të të dhënave, me qëllim krijimin e një harte dixhitale në internet për qëllime turistike.

OS2: Të promovojë dhe reklamojë potencialet turistike rajonale ndërkufitare përmes krijimit të një faqeje në internet, duke përdorur të dhënat gjeo-hapësinore.

OS3: Të lehtësojë kërkimin e informacionit dhe të orientojë lehtësisht turistët vendas e të huaj drejt pikave kryesore turistike dhe pasurive kombëtare natyrore e historike.



Rezultatet e pritshme dhe treguesit

R1: Struktura të themeluara, të pajisura dhe të trajnuara për të menaxhuar dhe programuar të dhëna gjeo-hapësinore dhe harta.
R2: Harta dixhitale e krijuar.
R3: Web-GIS i ngritur dhe funksional.
R4: Ndërgjegjësimi i vazhdueshëm për asetet rajonale nëpërmjet shpërndarjes së informacionit të strukturuar dhe profesional për turizëm, gjeo-hapësinorë dhe për çështjet social-kulturore.

Aktivitetet e projektit

1. Fillimi i projektit, punësimi i stafit teknik dhe trajnimi
 2. Identifikimi i të dhënave që do të mblidhen
 3. Mbledhja e informacionit në mënyrë fizike
 4. Dizajnimi i web-GIS
 5. Procesimi i të dhënave vektoriale
 6. Të dhënat dhe dizajnimi i hartave
 7. Shërbimi i hostimit të të dhënave gjeo-hapësinore dhe i domain-it
 8. Ngarkimi i të dhënave
 9. Dizajnimi i aplikacionit mobile dhe i web-it
 10. Përkthimi i portalit të web-it
 11. Përgatitja për raportin final dhe mbylljen e aksionit
 12. Workshop me operatorët turistik për promovimin e hartave në GIS
- Projekti mendohet të zbatohet për një periudhë 2-vjeçare.

Maturimi i projektit

Veprimi i propozuar synon të vendos themelet ku të mbështeten të gjitha projektet, private apo publike, përsa i përket mbledhjes, organizimit, analizimit dhe shpërndarjes së informacionit të saktë për rajonin. Ky është një hap i parë shumë i rëndësishëm dhe i nevojshëm për arrijtjen e suksesit të qëndrueshëm afatgjatë në rajon. Një bazë të dhënash e organizuar dhe e centralizuar është themeli i domosdoshëm mbi të cilin rajoni mund të planifikojë dhe të rritet në mënyrë efektive.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Nuk ka ende fonde të siguruar nga donatorët.
Projekti do të zbatohet nga:

- Agjencia e Zhvillimit Rajonal Kukës
- Këshilli i Qarkut Kukës
- Bashkia Kukës

Kostot e projektit

Fillimi i Projektit 1,000€
Punësimi i stafit teknik dhe trajnimi 36,000€
Identifikimi i të dhënave që do të mblidhen 2,000€
Mbledhja e informacionit në mënyrë fizike 20,000€
Dizajnimi i web-GIS 20,000€
Procesimi i të dhënave vektoriale 11,000€
Të dhënat dhe dizajnimi i hartave 10,000€
Shërbimi i hostimit të të dhënave gjeo-hapësinore dhe i domain-it 10,000€
Ngarkimi i të dhënave 10,000€
Dizajnimi i aplikacionit mobile dhe i web-it 20,000€
Përkthimi i portalit të web-it 5,000€
Përgatitja për raportin final dhe mbylljen e aksionit 5,000€
Seminar me operatorët turistikë për promovimin e hartave në GIS 10,000€
Promovimi i projektit (fletëpalosje, hartë turistike, guidë, konferenca, seminare, tv) 40,000€